



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 34 Akti

Nr. 23 Vendimi

Tiranë, më 07.06.2018

V E N D I M

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)
Suela Zhegu
Pamela Qirko

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. John Leonardo, në Tiranë, më datë 5 qershor 2018, ora 11:30 paradite, në Pallatin e Kongreseve, kati i 2-të, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Prençi**, prokuror i përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”; Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” .

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Suela Zhegu, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Dritan Prençi, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, me detyrë prokuror i përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (referuar si “Komisioni”). Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Suela Zhegu.

Me vendimin e datës 14.12.2017, trupa gjyquese ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtarin Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar Z. John Leonardo.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (referuar si “ILDKPKI”); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) dhe 3) Prokuroria e Përgjithshme (referuar si “PP”).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

1. *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi.”*

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Prokurorisë së Përgjithshme dhe denoncimet, nuk u gjetën indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 16.05.2018 vendosi përfundimin e hetimit

¹ Me shkresën me nr.***, datë 13.11.2017, e përbërë nga 12 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 16.01.2018, dërgohet raporti i Prokurorisë së Përgjithshme.

kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 21.05.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupës gjyquese, si dhe u lajmërua se ka të drejtë të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutura nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupës.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Dritan Prençi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit për Z. Dritan Prençi, me detyrë prokuror i përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, përfshin: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shoqëria "****" sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., dhe ALUIZNI.

I. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit organik nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit, të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatorja e çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

1. Apartament⁴ me sipërfaqe 71.46 m² (2+1), me vlerë 31,204 euro, i ndodhur në ***, Njësia Administrative Kashar, Tiranë, ZK nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***.

Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit⁵

Trupa gjyquese, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë apartament.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

2. Tokë bujqësore⁶, me sipërfaqe prej 3994 m² dhe 9054 m², me zotërim 1/8-ën e pasurisë si anëtar i familjes bujqësore, që sipas ligjit e ka përfutur i ati i subjektit. Kjo pasuri është akoma e paregjistruar dhe e pandarë ndërmjet anëtarëve të familjes bujqësore.

ZVRPP Dibër⁷, me shkresën nr. *** prot., datë 13.04.2018, konfirmon se në emër të R.R.P dhe Dritan Prençit është depozituar në ZVRPP Dibër akti i marrjes së tokës në pronësi, nr. *** prot., datë 1.9.1994, për sipërfaqen 3.994 m². Gjithashtu, janë dorëzuar në arkivin e ZVRPP-së Dibër aktet e marrjes së tokës në pronësi, nr. ***, ***, ***, ***, *** të familjes bujqësore të R.R.P, sipas gjendjes së certifikatës familjare, datë 01.08.1991. Pronat e mësipërme janë të paregjistruara, pasi nuk është bërë regjistrimi fillestar i pasurive për zonën Bardhaj-Rec. Bashkëlidhur përgjigjes së ZVRPP-së Dibër, gjenden aktet e marrjes së tokës në pronësi me nr. ***, ***, ***, ***, ***, datë 10.8.2014, të familjes bujqësore të R.R.P. Sipas certifikatës familjare, në bazë të regjistrimit themeltar të vitit 1974, familja e R.P përbëhej nga 8 anëtarë.

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

⁴ Subjekti për këtë pasuri i ka bashkëlidhur Deklaratës vërtetim të njësisë me origjinalin, nr. *** rep., datë 25.1.2017, për certifikatë pronësie nr. ***, lëshuar më datë 17.6.2011, të pasurisë “Apartament” me nr. ***, sipërfaqe 71.46 m², në emër të Dritan Prençit. (Bashkëngjitur kartela e pasurisë dhe harta treguese).

- Kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 31.5.2011. Palë shitëse, shoqëria “****” sh.p.k., dhe palë blerëse Dritan Prençi për apartamentin me sip. 71.46 m², nr. pasurie ***, vlerë 31.204 euro + praktika.
- Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., *** kol., datë 28.7.2008, për apartament me sipërfaqe ndërtimi 78.01 m², vlerë 31.204 euro, nga Dritan Prençi, te shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. + praktika.
- Dokumentacion për likuidimin e apartamentit në favor të kompanisë “****” sh.p.k.

⁵ Shih në dosjen e Komisionit shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2017, drejtuar ZQRPP.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vërtetim* nga ZVRPP Dibër, datë 23.01.2017, ku rezulton se disponohet akti i marrjes së tokës në pronësi, me nr. ***, datë 01.09.1994, ku është pajisur me tokë bujqësore në sipërfaqen 3994 m², me kryefamiljar R.P dhe AMTP nr. ***, ***, ***, ***, ***, datë 10.08.2014, për paisjen me tokë bujqësore. Bashkëlidhur ndodhen: Akti AMTP nr. ***, në emër të R.R.P. Shkresë nga Njësia Administrative Zall-Reç nr. ***, datë 23.12.2015, drejtuar ZVRPP Dibër, për pasuritë e regjistruara sipas AMTP në emër të familjes së R.P, në bazë të vendimit nr. 18, datë 10.05.2015, të Komunës Zall-Reç, akti nr. ***, ***, ***, ***, ***, datë 10.08.2018, si dhe certifikatën familjare.

⁷ Në dosjen e subjektit ndodhet shkresa e Komisionit me nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar ZVRPP-së Dibër, ku kërkohet informacion mbi pasuritë e regjistruara, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij.

3. Autoveturë⁸, e tipit “Volkswagen-Golf”, vit prodhimi 1998. Kjo pasuri është fituar sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 19.10.2011. Automjeti është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Laç, në kohën kur subjekti ka pasur vendbanimin në Laç. Vlera e këtij automjeti është deklaruar 2.000 (dy mijë) euro.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor⁹ (referuar si “DPSHTRR”) me shkresën nr. *** prot., datë 10.01.2018, konfirmon se në emër të Dritan Prençit figuron i regjistruar automjeti me targë ***.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri (makinë). Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer.

Gjendja e llogarive rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes të tij përputhet me deklarin e tyre.

Me shkresën nr. *** prot., datë 28.05.2018, subjekti i rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, lidhur me dy kontratat noteriale si qiramarrës, ka shpjeguar se ato janë kryer për t’u regjistruar si banor në zyrat e gjendjes civile respektive, si dhe këto apartamente nuk janë përdorur asnjëherë për banim.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit ishin bindëse dhe të mjaftueshme.

Rekomandimi për vlerësimin e pasurisë

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI-ja, për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm, është kryer hetim administrativ nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

Nga analiza financiare rezulton se për periudhën 2003-2016 subjekti, me të ardhurat e tij dhe bashkëshortes¹⁰, ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e pasurive të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 23.01.2017, nga DRSHTRR Laç, për automjetin në pronësi të Dritan Prençit, me targa ***.
- Kontratë shitblerjeje pasurie nr. *** rep., *** kol., datë 19.10.2011. Palë shitëse Z. K.K dhe palë blerëse Z. Dritan Prençi. Vlera e shitjes së automjetit 50.000 lekë. Deklarata doganore e automjetit, datë 9.11.2011, DOG 73.262 lekë, TVSH 73.256 lekë.

⁹ Shih në dosje shkresën e Komisionit nr. *** prot., datë 27.12.2017, me të cilën është kërkuar informacion për çdo automjet të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

¹⁰ Subjekti i bashkëngjitur dokumentacion justifikues:

¹⁰ Subjekti i bashkëngjitur dokumentacion justifikues:

- Vërtetim me nr. *** prot., datë 23.01.2017, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, qershor 2001 - mars 2005, shuma në vlerën 2.467.624 lekë;

Nga gjetjet e mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi.*

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si prokuror.

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

-
- Vërtetim me nr. *** prot., datë 23.01.2017, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, prill 2005 - shkurt 2007, shuma në vlerën 1.912.548 lekë;
 - Vërtetim me nr. *** prot., datë 23.01.2017, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, shkurt 2007 - tetor 2010, shuma në vlerën 6.715.568 lekë;
 - Vërtetim me nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin 2011 - mars 2013, shuma në vlerën 1.073.500 lekë;
 - Vërtetim me nr. *** prot., datë 13.01.2017, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës periudha 2011 - 31.12.2016. Shuma në vlerën 2.667.398 lekë;
 - Vërtetim me nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga ISSH, për A.Ç, periudha 01.07.2013 - 27.06.2014. Shuma në vlerën 165.406 lekë;
 - *Statement* të llogarisë së Dritan Prençit, nr. ***, nga BKT, për periudhën 01.09.2011 - 24.01.2017 me balancë llogarie në vlerën 28.395 lekë.

Raporti për analizën e aftësive profesionale, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit, në 3 (tri) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Në të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kjo analizë konstatohet:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej tij dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, e analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, apo me praktikën gjyqësore, kryesisht atë unifikuese të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese. Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Dritan Prençi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë të jetë vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Bazuar në 3 aktet e dorëzuara dhe në 5 dosjet e shortuara për subjektin Dritan Prençi, konstatohet lehtësisht mënyra e saktë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimit të prokurorit në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas ligjit. Vendimet e marra nga prokurori janë të qarta dhe të kuptueshme, ku konstatohet se respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve, i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

Në qëndrimin e mbajtur dhe kërkimet e prezantuara para gjykatës, rezultojnë që ato të jenë të arsyetuara, në kuptimin e përdorimit të një logjike që ndjek rregullat e një mendimi të drejtë. Po kështu, në kërkimet e tij, evidentohet të analizojë kërkesat e ligjit të aplikuar, si dhe të ketë ruajtur një raport të drejtë mes interesit publik, interesit të të dëmtuarve nga vepra penale/viktimitave, interesave të organit të akuzës dhe në mosshkeljen e të drejtave dhe lirive personale të të gjykuarve. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, i vlerësuar “shumë mirë” për tri vitet e fundit

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ndërkohë që ka përballuar një ngarkesë pune pothuajse si të gjithë prokurorët, fakt që e tregon dhe numri i çështjeve që ka pasur në hetim apo ato në kuadër të kryerjes së verifikimeve.

Nga vlerësimi i punës për tri vitet objekt vlerësimi dhe gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, rezulton se janë respektuar afatet e hetimit të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Nga analiza e të dhënave të mësipërme, që rezultojnë nga dosjet e kontrolluara, konstatohet se subjekti, Z. Dritan Prençi, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi, pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.

Nga vlerësimet e punës së subjektit Dritan Prençi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti Dritan Prençi është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, Z. Prençi, ka prezantuar aftësitë e nevojshme për kryerjen e veprimeve hetimore procedurale, drejtimin dhe kontrollin mbi këto veprime. Nga ana e tij janë kryer apo drejtuar veprimet përkatëse, mbi bazë të të cilave është vendosur pushimi i procedimeve penale apo dhe vendimmarrjes mbi materialet kallëzuese, ku në këto dosje rezulton që për vendimmarrjet të jenë kryer njoftimet përkatëse, cilësi këto të pasqyruara dhe në vlerësimet e bëra ndaj tij nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku është vlerësuar “*shumë mirë*”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

Në ushtrimin e rolit të tij si drejtues, ka treguar aftësi për të evidentuar veprimet hetimore të nevojshme për t’u kryer, duke udhëzuar prokurorin për kryerjen e tyre, nëpërmjet vendimmarrjes.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e

prokurorit, ku në lidhje me këtë karakteristikë, si dhe sa më sipër, është shprehur Prokurori i Përgjithshëm për subjektin Dritan Prençi në vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me vlerësimin e aftësive komunikuese, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësia e komunikimit

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është i gatshëm të punojë në grup dhe i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe i gatshëm të punojë në grup, si dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, ka marrë titullin “Jurist” më datë 15.07.2000 në Universitetin e Tiranës, pas kryerjes së periudhës së studimeve 1996 - 2000. Më datë 08.11.2013 ka përfunduar programin “Master shkencor – Penal”, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, Kosovë, ku ka mbrojtur temën “Vepra penale e korrupsionit sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, i ndjekur në vitet akademike 2008 - 2012.

Gjithashtu, ai ka paraqitur një tërësi dokumentesh që tregojnë pjesëmarrjen e tij aktive në trajnime të ndryshme, si më poshtë:

- Trajnime të kryera nga Shkolla e Magjistraturës.
- Jurisprudenca e GJEDNJ-së për çështjet kundër Shqipërisë, në fushën penale. Zbatimi në praktikën gjyqësore. Zhvilluar në datat 28 - 29 maj 2015.
- “Kuptimi i mashtrimit në sigurime, neni 145 i K. Penal. Problemet që evidentohen me praktikën e procedimeve dhe atë gjyqësore lidhur me cilësimin ligjor të kësaj vepre. Dallimi i kësaj vepre me veprat penale të tjera të kryera me anë të mashtrimit dhe konkurrimi i saj me vepra penale të tjera”. Zhvilluar në datat 29 - 30 qershor 2015.
- Veprat penale në fushën e tatimeve. Roli i sistemit të drejtësisë dhe bashkëpunimi me autoritetet në fushën e tatimeve. Zhvilluar në datat 21 - 22 nëntor 2016.

Në funksion të vlerësimit profesional, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan denoncimet e ardhura nga publiku. Pranë Komisionit janë depozituar dy denoncime:

1. Denoncimi i shtetasit H.T., me nr. *** prot., datë 23.01.2018, për shkelje të etikës profesionale, hetim jo i rregullt ligjor, me pretendimin se ka nxjerrë nga zyra avokatin e zgjedhur nga shtetasi H.T. Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka informuar se në përfundim të veprimeve verifikuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 02.03.2018, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal ndaj materialit kallëzues me nr. ***, të vitit 2018”, pasi fakti i pretenduar nga kallëzuesi nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar kjo në nenet 290/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 13.03.2018.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi H.T., rezultoi se nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.

2. Denoncim nr. *** prot., datë 17.04.2018, i shtetasit H.P., me objekt “Korrupsion, shpërdorim detyre, shkelje ligjore”. Nga verifikimi rezultoi që denoncuesi është akuzuar për veprën penale të falsifikimit, si dhe nga denoncimi nënkuptohet që kjo çështje është shqyrtuar në të tria shkallët e gjyqësorit.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi H.P., rezultoi se nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.

Rekomandimi për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet e mësipërme dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

a) Lidhur me aftësitë profesionale

- Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “*shumë mirë*”, çka tregon për aftësitë profesionale të tij, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht (si prokuror çështjeje), ashtu edhe në menaxhimin e drejtë e në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në vijimësi, ai e analizon normën penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me norma kushtetuese apo të ligjit penal dhe procedural.

Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në lidhje me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore.

Referuar vlerësimit të bërë për të në aspektin profesional rezulton se ai ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota, të konfirmuara edhe nga vlerësimet “*shumë mirë*” të Prokurorit të Përgjithshëm për vitet 2014, 2015, 2016.

Po ashtu, Z. Prençi ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional.

- Arsyetimi ligjor

Bazuar në 3 aktet e dorëzuara dhe në 5 dosjet e shortuara për subjektin Dritan Prençi, konstatohet lehtësisht mënyra e saktë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimit të prokurorit në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas ligjit. Vendimet e marra nga prokurori janë të qarta dhe të kuptueshme, ku konstatohet se respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar.

Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

Në qëndrimin e mbajtur dhe kërkimet e prezantuara para gjykatës, rezulton që ato të jenë të arsyetuara, në kuptimin e përdorimit të një logjike që ndjek rregullat e një mendimi të drejtë. Po kështu, në kërkimet e tij, evidentohet të analizojë kërkesat e ligjit të aplikuar, si dhe të ketë ruajtur një raport të drejtë mes interesit publik, interesit të të dëmtuarve nga vepra penale/viktimizeve, interesave të organit të akuzës dhe në mosshkeljen e të drejtave dhe lirive personale të të gjykuarve. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, i vlerësuar “*shumë mirë*” për tri vitet e fundit.

b) Lidhur me aftësitë organizative

- Aftësia për të përballuar ngarkesë në punë

Subjekti rivlerësimi, Z. Dritan Prençi, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ndërkohë që ka përballuar ngarkesë pune pothuajse si të gjithë prokurorët, fakt që e tregon dhe numri i çështjeve që ka pasur në hetim apo në kuadër të kryerjes së verifikimeve.

Nga vlerësimi i punës për tri vitet objekt vlerësimi dhe gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, rezulton se janë respektuar afatet e hetimit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale. Nga analiza e të dhënave të mësipërme, që rezultojnë nga dosjet e kontrolluara, konstatohet se subjekti Dritan Prençi ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi, pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.

Nga vlerësimet e punës së subjektit Dritan Prençi për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij.

- Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, ka prezantuar aftësitë e nevojshme për kryerjen e veprimeve hetimore procedurale, por dhe drejtimin dhe kontrollin mbi këto veprime, për të mbështetur në lidhje në çështjet me të pandehur, akuzën e ngritur dhe mënyrës së vërtetimit të kësaj akuze, apo dhe në çështjet për të cilat është vendosur pushimi, nga ana e tij janë kryer, apo drejtuar veprimet përkatëse mbi bazë dhe të të cilave është vendosur pushimi i procedimeve penale apo dhe vendimmarrjes mbi materialet kallëzuese, ku në këto dosje rezulton që për vendimmarrjet të jenë kryer njoftimet përkatëse, cilësi këto të pasqyruara dhe në vlerësimet e bëra ndaj tij nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku është vlerësuar “*shumë mirë*”.

- Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

Në ushtrimin e rolit të tij si drejtues, ka treguar aftësi për të evidentuar veprimet hetimore të nevojshme për t’u kryer, duke udhëzuar prokurorin për kryerjen e tyre, nëpërmjet vendimmarrjes.

c) Lidhur me angazhimin ndaj vlerave profesionale

- Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit, ku në lidhje me këtë karakteristike, si dhe sa më sipër, është shprehur Prokurori i Përgjithshëm për subjektin Dritan Prençi në vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku rezulton se është vlerësuar “*shumë mirë*” për etikën profesionale.

- Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij.

- Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Dritan Prençi. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, në asnjë prej dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 (pesë) dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me vlerësimin e aftësive komunikuese, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se vlerësimi ka qenë “*shumë mirë*”.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

- Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, si dhe 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti konstatohet se komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj kolegëve, vartësve dhe administratës ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur një sjellje shumë të mirë, i komunikueshëm dhe duke shfaqur kompetencë profesionale në diskutime teknike, për çështje të ndryshme, nisur dhe nga detyra e tij organizative si Drejtues i Prokurorisë. Ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Kjo është shfaqur dhe në vlerësimin e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku rezulton se është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë e komunikimit.

- **Aftësia për të bashkëpunuar**

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, si dhe 3 dokumentet ligjore, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka cilësi të mira bashkëpunuese, i gatshëm të punojë në grup, si dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

Kjo është shfaqur dhe në vlerësimin e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, lidhur me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar ku rezultoi se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

- **Gatishmëria për t’u angazhuar**

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Prençi, ka marrë titullin “Jurist” në datën 15.07.2000 në Universitetin e Tiranës pas kryerjes së periudhës së studimeve 1996 - 2000. Më datë 08.11.2013 ka përfunduar programin “Master shkencor – Penal”, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, Kosovë, ku ka mbrojtur temën “Vepra penale e korrupsionit sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, i ndjekur në vitet akademike 2008 - 2012. Gjithashtu, ai ka paraqitur një tërësi dokumentesh që tregojnë pjesëmarrjen e tij aktive në trajnime të ndryshme.

Pas hetimit të raportit të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimeve, nuk u gjet asnjë indice apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit, Z. Dritan Prençi.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 30.05.2018, trupa gjykuese, në prani të përfaqësuesit të vëzhguesve ndërkombëtarë, Z. John Leonardo, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, në seancë dëgjimore më datë 05.06.2018, ora 11:30 paradite, në Sallën e Konferencave, në pallatin e Kongreseve në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit. Z. Dritan Prençi është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, në datën 30.05.2018, për të cilin edhe ka komunikuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 5 qershor 2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht. Z. Preçi nuk paraqiti pretendime shtesë, deklaroi se ishte dakord me rezultatet e hetimit dhe kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se:

Së pari, trupa gjyquese mori në analizë kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të ILDKPKI-së, konkluzionet e nxjerra pas hetimit, informacionet e kërkuara nga subjektet e së drejtës publike, sipas nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe pretendimeve dhe provave të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në procesin e rivlerësimit të subjektit përfshihet kontrolli i pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. ILDKPKI-ja kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, si dhe për saktësinë e deklaramit.

Referuar nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të kontrollit inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; është kryer fshehje e pasurisë; është kryer deklarim i rremë; subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Neni 33 i ligjit, ndër të tjera, parashikon se inspektori i përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelit.

Kushtetuta i ka njohur ILDKPKI-së kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës dhe përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive,

saktësinë dhe plotësinë e deklaramit. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kushtetutëbërësi ka përcaktuar qartësisht organin që do ta kryejë procedurën e kontrollit të deklaratës dhe kompetencat e këtij organi, të cilat janë specifikuar më tej në ligjin nr. 84/2016. Edhe pse ligji ka parashikuar në mënyrë më të detajuar kompetencat e ILDKPKI-së dhe rolin e saj konkret në këtë proces, nuk rezulton që ato bien ndesh me kompetencën kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe as e cenon në thelb atë¹¹.

Hetimi administrativ i thelluar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratave në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Ky hetim është përqendruar, mbi të gjitha, te pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Z. Dritan Prençi.

Së dyti, trupa gjyquese mori në analizë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, raportin e arsyetuar të DSIK-së mbi pastërtinë figurës së subjektit të rivlerësimit.

Referuar nenit 35/2 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja menjëherë ka filluar procedurën e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, i cili ka plotësuar formularin përkatës. DSIK-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit të figurës së subjektit, sipas parashikimeve të neneve 34 deri në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe ka përfunduar kontrollin për figurën e subjektit të rivlerësimit, ka dërguar raportin përfundimtar, sipas të cilit ka konstatuar përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së prokurorit Dritan Prençi.

Komisioni, pasi ushtroi të drejtën e kontrollit të pastërtisë të figurës së subjektit të rivlerësimit, konstatoi se nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Së treti, trupa gjyquese mori në analizë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, konkluzionet e nxjerra pas hetimit të denoncimeve.

Në përfundim të kësaj analize, nuk u gjet asnjë indice apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenon figurën e prokurorit, Z. Dritan Prençi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për

¹¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Z. Dritan Prençi, me funksion prokuror i përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall më datë 7 qershor 2018, ora 10:30.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesues

Suela ZHEGU
Relator

Pamela QIRKO
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida GOXHAI

